



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-07
Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 3 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidenciale

**Vendim mbi procedurën e rishikimit të paraburgimit dhe caktimin e datës së
synuar për vendim sipas nenit 39(2)**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit për Hysni Gucatin
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bouden

Mbrojtësit për Nasim Haradinajn
Bastian Martens

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenet 41 dhe 39(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 57, 85(5) dhe 86 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi, sipas kërkesës,² fletarrestimet kundër Hysni Gucati (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”) (bashkërisht, “të dyshuarit”), si dhe urdhrat për transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë (“objekti i paraburgimit i DHS-së”).³
2. Më 25 shtator 2020, të dyshuarit u arrestuan në Kosovë.⁴ Z. Gucati dhe z. Haradinaj u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së, përkatësisht më 25 dhe 26 shtator 2020.⁵
3. Më 29 shtator dhe 1 tetor 2020, z. Haradinaj dhe z. Gucati bënë paraqitjet e para përkatëse (bashkërisht, “paraqitjet e para”), gjatë të cilave u informuan për arsyet e

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 29 tetor 2020, publike.

² KSC-BC-2020-07, F00009RED, Prokurori i Specializuar Versioni publik i redaktuar i ‘Kërkesës urgjente për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to’, parashtim i protokolluar KSC-BC-2020-07-F0009 të datës 22 shtator 2020, 1 tetor 2020, publike, me shtojcat 1-2, publike.

³ KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, Versioni publik i redaktuar i fletarrestimit për Hysni Gucatin (“Fletarrestimi për z. Gucati”), 24 shtator 2020, publike; KSC-BC-2020-07, F00012/A03/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, Versioni publik i redaktuar i versionit të korrigjuar të fletarrestimit për Nasim Haradinajn (“Fletarrestimi për z. Haradinaj”), 24 shtator 2020, publike; KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, Versioni publik i redaktuar i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 24 shtator 2020, publike; KSC-BC-2020-07, F00012/A04/RED, Gjykatësi i Vetëm, Versioni publik i redaktuar i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 24 shtator 2020, publike.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4), 25 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00016, Administratorja, Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4), 25 shtator 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-07, F00018, Administratorja, Njoftim për pranimin e Hysni Gucati në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 25 shtator 2020, publike, me Shtojcën 1, konfidenciale; KSC-BC-2020-07, F00020, Administratorja, Njoftim për pranimin e Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 26 shtator 2020, publike, me shtojcën 1, konfidenciale.

arrestimit.⁶ Gjatë paraqitjes së parë të z. Haradinaj, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) bëri të ditur se priste që të paraqiste aktakuzën kundër të dyshuarve brenda 30 ditësh.⁷

4. Më 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi “Vendimin mbi kundërshtimet e Mbrojtjes”.⁸ Në të njëjtën ditë, ai lëshoi “Urdhrin në lidhje me kërkesën për lirimin e menjëhershëm të Nasim Haradinajt” dhe “Vendim mbi kërkesën për dorëzani”, ku i hidhte poshtë kundërshtimet e Mbrojtjes për vazhdimin e paraburgimit të të dyshuarve.⁹

5. Më 30 tetor 2020, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* kundër të dyshuarve (“Aktakuza”), duke kërkuar konfirmimin e saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹⁰

6. Më 11 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkoi parashtrime prej palëve me shpresë që Aktakuza (versioni i redaktuar) t’i vihet në dispozicion Mbrojtjes dhe t’i lejohet që të bëjë parashtrime gjatë kohës që Aktakuza rishikohet nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Urdhër për parashtrime”).¹¹

⁶ KSC-BC-2020-07, Transkript, 29 shtator 2020, publike; KSC-BC-2020-07, Transkript, 1 tetor 2020, publike.

⁷ KSC-BC-2020-07, Transkript, 1 tetor 2020, publike, p. 15. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07, Transkript, 29 shtator 2020, publike, faqet 12-13.

⁸ KSC-BC-2020-07, F00057, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi kundërshtimet e Mbrojtjes*, 27 tetor 2020, publike.

⁹ KSC-BC-2020-07, F00058, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim në lidhje me kërkesën për lirim të menjëhershëm të Nasim Haradinajt*, 27 tetor 2020, publike, para. 33; KSC-BC-2020-07, F00059, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi kërkesën për dorëzani*, 27 tetor 2020, publike, para. 25.

¹⁰ KSC-BC-2020-07, F00063, Prokurori i Specializuar, *Paraqitja e Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesat e lidhura me të*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹¹ KSC-BC-2020-07, F00065, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për parashtrimet mbi procedurën e rishikimit të Aktakuzës*, 11 nëntor 2020, konfidenciale.

7. Më 16 nëntor 2020, Mbrojtja e Gucatit dhe Mbrojtja e Haradinajt bënë parashtrime me shkrim.¹² ZPS-ja e bëri këtë më 17 nëntor 2020.¹³

8. Më 25 nëntor 2020, Mbrojtja e Gucatit paraqiti kërkesë për udhëzime mbi procedurën e rishikimit të paraburgimit (“Kërkesë për udhëzime”).¹⁴

II. PARASHTRIMET

9. Mbrojtja e Gucatit parashtron se duhet t’i jepet qasje në Aktakuzë dhe në shtojcat e saj dhe të lejohet të bëjë parashtrime në lidhje me të ndërsa bëhet rishikimi i saj.¹⁵ Për më tepër, ZPS-ja duhet të propozojë kategoritë e redaktimit të Aktakuzës, të cilave Mbrojtja do t’i përgjigjej.¹⁶

10. Mbrojtja e Haradinajt parashtron se, për t’u përgatitur për seancën e ardhshme për paraburgimin, Mbrojtjes duhet t’i lejohet qasje në Aktakuzën e paredaktuar dhe në të gjithë materialin mbështetës.¹⁷ Ajo gjithashtu kërkon që këto dokumente të riklasifikohen si “publike”.¹⁸

¹² KSC-BC-2020-07, F00066, Mbrojtja e Gucatit, *Parashtrime mbi procedurën e rishikimit të Aktakuzës* (“Parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit”), 16 nëntor 2020, konfidenciale; KSC-BC-2020-07, F00067, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrime mbi procedurën e rishikimit të Aktakuzës* (“Parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt”), 16 nëntor 2020, konfidenciale.

¹³ KSC-BC-2020-07, F00068, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë mbi procedurën e rishikimit të Aktakuzës* (“Parashtrimet e ZPS-së”), 17 nëntor 2020, konfidenciale.

¹⁴ KSC-BC-2020-07, F00069, Mbrojtja e Gucatit, *Kërkesë për udhëzime: Lënda Procedura e rishikimit të Aktakuzës*, 25 nëntor 2020, konfidenciale.

¹⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit, para. 6. Gjykatësi i Procedurës Paraprake sqaron për Mbrojtjen se parashtrimi i protokolluar, i cituar në shënimin 10 më lart, përmban vetëm dy shtojca. Në urdhrin për parashtrime gabimisht thuhej se parashtrimi i ZPS-së përmbante “shtojcat 1-3, konfidenciale dhe *ex parte*”, *Shih* Urdhri për parashtrime, poshtëshënimin 10.

¹⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit, para. 7.

¹⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt, paragrafët 1-2, 4-5. Ndërsa në dy paragrafët e fundit të parashtrimeve Mbrojtja e Haradinajt kërkon qasje në “Aktakuzën e plotë dhe të paredaktuar dhe të gjitha materialet mbështetëse”, më lart në parashtrim e formulon kërkesën edhe më gjerë duke përfshirë “aktakuzën e plotë dhe të paredaktuar dhe të gjitha materialet e mbledhura nga ZPS-ja në çështje; *Shih* Parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt, paragrafët 2, 4-5.

¹⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt, para. 5.

11. ZPS-ja e kundërshton dhënien e Aktakuzës Mbrojtjes para konfirmimit të saj,¹⁹ duke argumentuar se: (i) Ligji dhe Rregullorja nuk parashohin që Mbrojtjes t'i jepet Aktakuza në këtë fazë dhe nuk ka arsye për të vepruar ndryshe në këtë çështje;²⁰ (ii) paraburgimi i të dyshuarve është i bazuar në fletarrestimet të cilat ata i kanë parë, e për këtë arsye nxjerrja e Aktakuzës për Mbrojtjen është e panevojshme dhe e parëndësishme për kundërshtimin e paraburgimit të tyre;²¹ dhe (iii) vënia e Aktakuzës në dispozicion të Mbrojtjes mund të ketë pasoja negative për integritetin e provave dhe mund të paragjykojë hetimet.²² Si alternativë, ZPS-ja pajtohet që Aktakuza t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes, por kërkon që "Paraqitja e Fakteve" të redaktohet tërësisht në Aktakuzë, dhe që Mbrojtja të mos lejohet të bëjë parashtrime në lidhje me Aktakuzën ndërsa është duke u rishikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.²³

12. Së fundi, duke iu referuar faktit se z. Gucati është në paraburgim dy muaj që nga arrestimi,²⁴ Mbrojtja e Gucatit kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të japë udhëzime në lidhje me kryerjen e rishikimit të paraburgimit të z. Gucati, përfshirë vënien e Aktakuzës në dispozicion të Mbrojtjes dhe më pas shkëmbimin e parashtrimeve në lidhje me rishikimin e paraburgimit.²⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

13. Në përputhje me rregullën 57(2) të Rregullores, pas caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në përputhje me nenin 33(1)(a) të Ligjit dhe deri në aktgjykimin përfundimtar, paneli i ngarkuar me çështjen e rishikon vendimin për paraburgim pas dy muajsh nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, në përputhje me nenin

¹⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1.

²⁰ Parashtrimet e ZPS-së, paragrafët 1, 10-12.

²¹ Parashtrimet e ZPS-së, paragrafët 1, 13-14.

²² Parashtrimet e ZPS-së, paragrafët 1, 15-18.

²³ Parashtrimet e ZPS-së, paragrafët 1-2, 21-27.

²⁴ Kërkesa për udhëzime, paragrafët 7-8

²⁵ Kërkesa për udhëzime, paragrafi 9.

41(6), (10), (11) dhe (12) të Ligjit, ose në çdo kohë me kërkesë të të akuzuarit ose të Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*, kur ka ndryshime të rrethanave që nga rishikimi i fundit.

14. Në përputhje me rregullën 85(5) të Rregullores, data e parashikuar për vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi konfirmimin ose hedhjen poshtë të aktakuzës është, në varësi të veçorive të çështjes, jo më vonë se gjashtë muaj nga protokollimi i aktakuzës dhe të gjithë materialit mbështetës.

IV. DISKUTIM

15. Duke u marrë së pari me kërkesën e Mbrojtjes së Gucatit për udhëzime në lidhje me rishikimin e paraburgimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, në përputhje me rregullën 57(2) të Rregullores, vendimi për paraburgim duhet të rishikohet pasi të kenë kaluar dy muaj “nga vendimi i fundit për paraburgimin”. Periudha prej dy muajsh ka filluar më 27 tetor 2020, kur u nxorën vendimet e fundit në lidhje me paraburgimin në këtë çështje, që do të thotë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet ta rishikojë paraburgimin e të dyshuarve përsëri jo më vonë se 27 dhjetor 2020. Para këtij rishikimi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë parashtrime nga palët.²⁶ Paraburgimi gjithashtu mund të rishikohet në çdo kohë me kërkesë të Mbrojtjes, Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*, kur ka ndryshime të rrethanave që nga rishikimi i fundit.²⁷

16. Duke kaluar në vënien e Aktakuzës së pakonfirmuar në dispozicion të Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje të drejtat e personave të paraburgosur,

²⁶ *Shih p.sh.* KSC-BC-2020-05, F00048, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për parashtrime mbi rishikimin e paraburgimit*, 16 nëntor 2020, publike.

²⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, edhe pse rregulla 57(2) e Rregullores i referohet “të akuzuarit”, ajo domosdoshmërisht duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që të përfshijë edhe të dyshuarin i cili është në paraburgim ndërsa është duke u rishikuar aktakuza (dhe, si rrjedhojë pas caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake), si në çështjen aktuale.

siç janë përcaktuar në nenin 5 të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("KEDNJ") dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("GJEDNJ"). Konkretisht, në përputhje me nenin 5(2) të KEDNJ-së, personit të arrestuar dhe/ose të paraburgosur²⁸ duhet t'i tregohen – në gjuhë të thjeshtë joteknike që mund të kuptohet lehtë – arsyet thelbësore ligjore dhe faktike për arrestimin dhe/ose paraburgimin, në mënyrë që të jetë në gjendje, nëse ai ose ajo e konsideron të arsyeshme, t'i kërkojë gjykatës që ta kundërshtojë ligjshmërinë në përputhje me nenin 5(4) të KEDNJ-së.²⁹ Ndërsa neni 5(2) i KEDNJ-së nuk kërkon që personit të paraburgosur t'i lejohet qasje në të gjithë dosjen e çështjes, sidoqoftë, ai duhet të marrë informacion të mjaftueshëm që të jetë në gjendje të argumentojë rishikimin e ligjshmërisë siç parashihet me nenin 5(4) të KEDNJ-së.³⁰ Se a është përmbajtja e informacionit të dhënë e mjaftueshme duhet të vlerësohet në bazë të veçorive të secilës çështje.³¹

17. Në nenin 5(2) të KEDNJ-së nuk kërkohet që në momentin kur personi arrestohet me dyshimin se ka kryer krim duhet t'i jepet informacioni i nevojshëm në formë të caktuar, e as nuk thotë se ky informacion duhet të përmbajë listën e plotë të akuzave

²⁸ *Shih p.sh.* ECtHR /GJEDNJ, *Athary v. Turkey*, no. 50372/09, Judgment ("*Athary Judgment*"), 11 December 2012, para. 35; *Abdolkhani and Karimnia v. Turkey*, no. 30471/08, Judgment ("*Abdolkhani and Karimnia Judgment*"), 22 September 2009, para. 136; *Shamayev and Others v. Georgia and Russia*, no. 36378/02, Judgment ("*Shamayev and Others Judgment*"), 12 April 2005, para. 414.

²⁹ *Shih p.sh.* GJEDNJ, *Musaev v. Turkey*, no. 72754/11, Judgment, 21 October 2014, para. 34; *T. and A. v. Turkey*, no. 47146/11, Judgment, 21 October 2014, para. 65; *Athary Judgment*, para. 35; *X. v. France*, no. 20335/04, Judgment ("*X. v. France Judgment*"), 20 November 2008, para. 59; *H.B. v. Switzerland*, no. 26899/95, Judgment ("*H.B. v. Switzerland Judgment*"), 5 April 2001, para. 47; *Abdolkhani and Karimnia Judgment*, para. 136; *Shamayev and Others Judgment*, para. 413; *Fox, Campbell and Hartley v. The United Kingdom*, nos 12244/86, 12245/86, 12383/86, Judgment ("*Fox, Campbell and Hartley Judgment*"), 30 August 1990, para. 40; *Čonka v. Belgium*, no. 51564/99, Judgment ("*Čonka Judgment*"), 5 February 2002, para. 50; ECtHR, *Danov v. Bulgaria*, no. 56796/00, Judgment ("*Danov Judgment*"), 26 October 2006, para. 67.

³⁰ *Shamayev and Others Judgment*, para. 427; *Shih gjithashtu Danov Judgment*, para. 69.

³¹ *Shih p.sh.* *Athary Judgment*, para. 35; *X. v. France Judgment*, para. 59; *H.B. v. Switzerland Judgment*, para. 47; *Abdolkhani and Karimnia Judgment*, para. 136; *Shamayev and Others Judgment*, para. 413; *Fox, Campbell and Hartley Judgment*, para. 40; *Čonka Judgment*, para. 50; *Danov Judgment*, para. 67.

kundër personit të arrestuar.³² Sidoqoftë, kjo linjë e jurisprudencës nuk e mbështet pretendimin se informacioni shtesë në lidhje me akuzat duhet të jepet në cilëndo fazë pas arrestimit, si në çështjen aktuale.

18. Rrjedhimisht, në çështjen aktuale, Mbrojtjes mund t'i vihet në dispozicion informacion i mjaftueshëm për të qenë në gjendje që të kundërshtojë arsyet ligjore dhe faktike për mbajtjen e të dyshuarve në paraburgim. Qasja e Mbrojtjes në informacion relevant të Aktakuzës do t'i mundësonte të paraqiste parashtrime të njëmendta në lidhje me rishikimin e paraburgimit të të dyshuarve.

19. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i informon palët se vendimi në lidhje me rishikimin e Aktakuzës do të nxirret të premtën, 11 dhjetor 2020. Nëse konfirmohet Aktakuza, Mbrojtjes do t'i lejohet qasje shumë shpejt pas kësaj. Meqenëse rishikimi i paraburgimit të të dyshuarve do të duhej të bëhej deri më 27 dhjetor 2020, Mbrojtja do të jetë në gjendje të bëjë parashtrime atëherë pasi t'i lejohet qasja në Aktakuzën e konfirmuar, nëse do të ketë.

20. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh kohën e vendimit të pritshëm për rishikimin e Aktakuzës dhe qasjen e Mbrojtjes në Aktakuzën e konfirmuar pas kësaj, si dhe afatin për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të të dyshuarve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se në rrethanat aktuale është e panevojshme që të vendoset në lidhje me dhënien e informacionit relevant në Aktakuzë Mbrojtjes. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu nuk ka nevojë që të vendosë në lidhje me kuadrin e çfarëdo parashtrimi që Mbrojtja do të lejohej të bënte sikur t'i ishte lejuar qasje në Aktakuzë, e as në lidhje me materialet në mbështetje të Aktakuzës.

³² GJEDNJ, *Nowak v. Ukraine*, no. 60846/10, Judgment, 31 March 2011, para. 53; *X. v. Federal Republic of Germany*, no. 8098/77, Commission Decision, 13 December 1978, pp. 111, 113; *X. v. The United Kingdom*, no. 4220/69, Commission Decision, 3 February 1971.

V. VENDIM

21. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **PËRCAKTON** se një vendim në pajtim me nenin 39(2) të Ligjit të premtën,
11 dhjetor 2020.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte, 3 dhjetor 2020

Në Hagë, Holandë.